



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 58A/2023  
Data: 19.01. 2023

### PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e dymbëdhjetë - XII- për vitin 2022 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 21.12.2022 me fillim pune në ora 13:00 në sallën e takimeve. Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete.

#### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Hartimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023.
3. Hartimi i Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022.
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- Mendoj që duhet në rend të punës duhet të futet edhe një pikë e rendit të punës Mos azhureteti i kujdestarisë mjekësore ne QKMF

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Hartimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023.
3. Hartimi i Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022.
4. Mos azhureteti i kujdestarisë mjekësore ne QKMF
5. Te ndryshme .

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2 Hartimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023

**Kryesuesi** thekson:- përveç pikave të cilat janë paraparë në planin e punës për vitin 2023 diçka të veçantë nuk kam.

<b><u>JANAR</u></b>	
1	Njohuri me kompetencat e Komitetit për Komunitete
2	Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë.
3	Rastet Sociale në komunën e Hanit të Elezit.
4	Takim me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale.
5	Eventuale
<b><u>SHKURT</u></b>	
1	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2	Takim me Drejtorinë e Administratës.
3	Identifikimi i dhe parandalimi i dukurive negative në Komunën e Han të Elezit.
4	Eventuale
<b><u>MARS</u></b>	
1	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2	Takim me Kryesuesin e Këshillit të Prindërve,të Shkollave.
3	Takim me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomi .
4	Takim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimit Rural.
5	Eventuale
<b><u>PRILL</u></b>	
1	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2	Takim me Zyrtarin e Zyrës për barazi gjinore. (Lufta kundër dhunës)
3	Takim me Zyrtarin e Zyrës Kadastrale.
4	Takim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
5	Eventuale

**MAJ**

1	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2	Takim me Kryesuesit e dy Komiteteve Konsultative.
3	Takim me përfaqësuesit e dy Këshillave të Fshatrave.
4	Takim me Përfaqësuesin e Bizneseve në Han të Elezit
5	Eventuale

**QERSHOR**

1	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2	Takim me Nënkryetarin e Komunës.
3	Takim me përfaqësuesin e HENDIKOS në Han të Elezit.
4	Eventuale

**KORRIK**

1	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2	Takim me Zyrtarin e Zyrës së Prokurimit.
3	Takim me Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojte të Mjedisit.
4	Eventuale

**GUSHT**

1	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2	Takim me Zyrtarin e Zyrës për Informim dhe transparence.
3	Takim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.
4	Takim me përfaqësuesit e BI në Han të Elezit.
5	Eventuale

**SHTATOR**

1	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2	Takim me Zyrtarin e Zyrës Ligjore.
3	Takim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.
4	Eventuale

### 3. Hartimi i Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022.

**Kryesuesi** thekson:- duhet të hartohet raporti i punës për shkak se duhet ta përcjellim në kuvend të komunës. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të rendit të punës të paraparë sipas agjendës.

### 4. Mos azhureteti i kujdestarisë mjekësore në QKMF

**Kryesuesi** thekson:- një rast që ka ndodhur në QKMF në orën katër të mëngjesit, ku një pacient shkon të kërkon shërbim por ekipi mjekësor nuk është prezent në punë , ai kishte hipertension ku pacienti merr një injeksion për ulje të tensionit por nuk shkruhet në evidencë që ka qenë në QKMF, pasi që merr injeksionin mjeku thotë që është në rregull mundet me shkuar në shtëpi . Pacienti përsëri ka kërkuar shërbim të nesërmen në QKMF gjatë ditës , por jo tek mjeku i natës së kaluar , ai përsëri merr injeksion për ulje të tensionit dhe mjeku i tregon që duhet të qëndroj diku 30 min për të reaguar injeksioni . Ai thekson që në natën e kaluar mjeku nuk e ka udhëzuar për të qëndruar pacientin 30 min në QKMF.

### 5. Të Ndryshme

Nuk pati diskutime.

Procesmbajtësi  
Sara Berisha

*Sara Berisha*

Kryesuesi i Komitetit  
Mefail Surna

*Mefail Surna*

